



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300561/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në  
Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Kukës.

**Drejtuar:** Z. Admir ABRIJA  
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

Z. Ylber DURAKU  
Drejtor i IEVP-së në Kukës

**KUKËS**

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet pas inspektimit të paparalajmëruar që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Kukës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim më datë 15.06.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të paraburgosurve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me aktet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat themelore të të burgosurve.

Aspekt tjetër i inspektimit, ishte edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e zhvilluar nga grupi i MKPT-së në datë 29.09.2022. Në përfundim,

gjetjet e atij inspektimi dhe rekomandimet për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve, janë dërguar me shkresë DPB-së dhe IEVP Kukës<sup>1</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Bazuar në metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet e sistemit penitenciar, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e IEVP Kukës z. Ylber Duraku. Drejtuesi dhe stafi i institucionit, u informuan nga grupi i MKPT-së në lidhje me qëllimin e inspektimit dhe ambientet që do të inspektohen në regjimin e brendshëm, intervistimin e të paraburgosurve, si dhe për këqyrjen e dokumentacionit dhe administrimin e tij.

Drejtori i IEVP-së informoi grupin e inspektimit në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve në këtë IEVP, plotësimin e kushteve materiale në dhomat e banimit, gjendjen shëndetësore të të paraburgosurve, mënyrën e zgjidhjes së kërkesë/ankesave të tyre nga stafi i institucionit, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Nga informacioni rezultoi se, IEVP Kukës klasifikohet institucion paraburgimi sipas urdhrin nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrisë të Drejtësisë "Për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale".

Kapaciteti fizik i institucionit është për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 36 personave të paraburgosur<sup>2</sup>. Në momentin e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm ndodheshin **42** të paraburgosur (asnjëri prej tyre nuk ishte i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata). Për rrjedhojë në **institucion ishin 6 persona të paraburgosur** mbi kapacitetin fizik të institucionit.

Kjo situatë mbipopullimi kishte ndikuar në përkeqësimin e kushteve të jetesës të të paraburgosurve, sidomos në dhomat e banimit ku ishin akomoduar 2, 3, 4 dhe 6 persona. Kjo situatë e mbipopullimit, kishte cënuar parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit. Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në ambientet e këtij institucioni.

Grupi i inspektimit mori të dhëna mbi popullimin në këtë institucion edhe për periudhën e fundit 6 mujore dhe nga statistikat e raportuara rezultoi se, në IEVP Kukës ka patur situata mbipopullimi. Dinamika e popullimit të institucionit për këtë periudhë ka qenë si më poshtë vijon:

- Muaji Janar            41 të paraburgosur
- Muaji Shkurt        39 të paraburgosur
- Muaji Mars            40 të paraburgosur

<sup>1</sup> Dërguar shkresë nr. K4/69-2 prot., datë 25.11.2022 "Rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve në IEVP Kukës".

<sup>2</sup> Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 5719 prot, datë 05.05.2023 "Për miratimin e kapaciteteve të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale".

- Muaji Prill 35 të paraburgosur
- Muaji Maji 40 të paraburgosur
- Muaji Qershor 42 të paraburgosur

Sikurse paraqitet nga grafiku i statistikave, rezulton se IEVP Kukës ka patur popullim në kapacitetin fizik të institucionit, gjatë periudhës 6-mujore. U konstatua nga inspektimi se episode të herëpashërshme mbipopullimi përgjithësisht të të paraburgosurve ishin mbi kapacitet, ku ata ishin të pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuara për 2, 3, 4 dhe 6 persona, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese.

Konkretisht, në shumicën e dhomave ku ishin akomoduar personat, hapësira dhe sipërfaqja e banimit nuk i përgjigjej parametrave teknike dhe jetësore që i takon çdo personi, sikurse është e miratuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, por edhe larg standardeve ndërkombëtare që synohen të arrihen për këtë qëllim<sup>3</sup>.

Rritja e numrit të shtretërve brenda dhomave të banimit është në kundërshtim edhe me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ku sipas këtij urdhri është përcaktuar kapaciteti për akomodimin e të burgosurve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Ndonse numri i personave mbi kapacitet nuk është shumë i madh, 6 persona mbi kapacitet në përqindje ky numer përbën përkatësisht 16% për këtë arsye kërkohet të adresohet kjo çështje.

Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron si një problematikë të qenësishme, duke pasur parasysh kapacitetet e lejuara për akomodimin e të paraburgosurve në këtë institucion.

Theksojmë se Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tij në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018, ka rekomanduar për IEVP-të, se: *“Edhe pse numri i përgjithshëm i të paraburgosurve është ulur krahasuar me vizitat e mëparshme, autoritetet shqiptare duhet të mbajnë në konsideratë mangësinë e përmbushjes së standardit minimal prej 4 m<sup>2</sup> të hapësirës për person, kur në to sistemohen më shumë persona (në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit që mund të ndodhet brenda dhomës). Ky shqetësim është adresuar edhe në rekomandimet tona të mëparshme, bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, standard i cili duhet të respektohet plotësisht në praktikë”*<sup>4</sup>.

Organika e IEVP-së Kukës përbëhej nga 58 punonjës, nga të cilët 17 janë staf civil dhe 41 janë punonjës të sigurisë së burgut. Nga verifikimi i organikës, rezultoi se kishte mungesa në pozicionin e mjekut me kohë të plotë (aktualisht mjeku ishte i punësuar me kohë të pjesshme), si dhe 4 (katër) punonjës policie të rolit bazë. Këto mungesa nuk ndikonin në plotësimin e kërkesave dhe nevojave bazë për të paraburgosurit.

<sup>3</sup> Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: *“Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m<sup>2</sup> për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”*.

<sup>4</sup> shih: <https://rm.coe.int/168097986b> “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019 ) fq. 32.

Nga ana e drejtuesit dhe stafit të institucionit, grupit të inspektimit ju ofrua akses i plotë, për kryerjen e inspektimit në të gjitha ambientet e brendshme të tij, si dhe zhvillimin e intervistave me personat e paraburgosur që vuanin dënimin në këtë institucion.

Nga verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, gjendja paraqitet si më poshtë vijon:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për nxjerrjen e urdhrit për rritjen e kapaciteteve fizike të institucionit, me qëllim uljen e popullimit në dhomat e banimit, duke ruajtur kushtet shëndetësore dhe higjienike të të paraburgosurve.
2. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe edukative të alternuara me programe për trajtime individuale të të paraburgosurve, me qëllim rehabilitimin, këshillimin, ri-integrimin, në përshtatje me kushtet e institucionit.

Ndërkohë, u evidentua se një pjesë e rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm nuk kishin gjetur zbatim. Më konkretisht:

3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për planifikimin e fondeve për rikonstruksionin e plotë të godinës së regjimit të brendshëm, për eliminimin e lagështirës në këto ambiente, si dhe për garantimin e trajtimit dinjitoz dhe kushteve normale të jetesës, për të paraburgosurit.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ricaktimin e sipërfaqeve të banueshme të institucionit dhe të kapacitetit të tij, përse edhe vendodhja (pjesërisht nën tokë) krijon premisa për kushte të papërshtatshme.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për blerjen e një aspiratori për ajrim në kuzhinën e institucionit.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e vendeve vakante për mjekun me kohë të plotë dhe për sektorin e policisë së institucionit.

Në lidhje me nevojat për plotësimin e kushteve të të paraburgosurve për jetesë normale dhe trajtimin dinjitoz të tyre, institucioni i IEVP Kukës i është drejtuar me shkresë DPB-së Tiranë<sup>5</sup>, ku evidentohen nevojat sipas sektorëve dhe kërkesa për mbështetja buxhetore për realizimin e tyre.

Grupi i inspektimit, në përfundim të vizitës monitoruese e njohu stafin e IEVP Kukës, me gjetjet kryesore dhe problematikat e konstatuara nga inspektimi, të cilat do gjejnë pasqyrim në një raport me rekomandime për drejtuesit e DPB-së dhe IEVP Kukës.

### **Trajtimi i të paraburgosurve**

Gjatë vizitës inspektuese u zhvilluan takime dhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, me qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me trajtimin e tyre. Në

---

<sup>5</sup> Shkresë nr.1289 prot., datë 07.06.2023 drejtuar DPB-së nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës.

përfundim, grupi i MKPT-së nuk identifikoi asnjë rast të përdorimit të presionit psikologjik ndaj të paraburgosurve, ushtrimit të dhunës fizike apo dhe ushtrimit të forcës tej kufijve që parashikohet në aktet normative në fuqi. Gjithashtu, nga këqyrja e regjistrimit të kërkesë/ankesave që administrohej nga zyra e protokollit të institucionit, nuk kishte të evidentuara ankesa apo pretendime të të paraburgosurve për ushtrim të dhunës fizike apo psikologjike nga punonjësit e policisë së burgut.

Një nga problematikat që u evidentua në intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte me mungesën e ajrimit dhe të dritës natyrale, për shkak të pozicionit të godinës së paraburgimit, e cila ndodhet nën nivelin e tokës dhe përmasat e dritareve të dhomave, të cilat janë të vogla. Dritaret e dhomave, veç përmasave konstatohen se janë dhe të amortizuara, pasi ato nuk mbylleshin hermetikisht dhe kjo përbënte shkak që ambientet të ishin të ftohta, sidomos gjatë stinës së dimrit, ku temperaturat në këtë zonë shkojnë nën zero. Në trajtimin e këtyre çështjeve me drejtuesit e institucionit, ata theksuan faktin se në pamundësi që dritaret ekzistuese të zgjerohen në përmasa, kishin bërë kërkesë DPB-së që ato të mund të zëvendësohen me dritare me “Duroplast”, që do të bënte të mundur izolimin nga i ftohti për çdo dhomë gjatë stinës së dimrit dhe ambientet do të jenë më të ngrohta dhe hermetike.

Gjatë inspektimit u evidentua gjithashtu dhe mungesa e sistemit të ngrohjes në regjimin e brendshëm (kaldajë) me gaz, si kërkesë e domosdoshme për të përballuar kushtet atmosferike me temperatura tepër të ulëta gjatë stinës së dimrit. Aktualisht, ngrohja në dhomat e banimit realizohet me pajisje elektrike të lejuara nga institucioni, por për shkak të ngarkesës, rrjeti elektrik nuk e përballon ngrohjen me këto pajisje. Për këtë arsye drejtuesit e institucionit ishin drejtuar me kërkesë DPB-së për instalimin e një kaldaje qëndrore me gaz, për përballimin e temperaturave të ulëta gjatë dimrit.

Shtetasit e huaj që vuanin dënimin në këtë institucion, ngritën si problematikë pamundësinë për të blerë produkte ushqimore shtesë apo materiale që nevojiten për higjienën personale të tyre, pasi nuk mund ti siguronin nga familjarët e tyre për shkak të largësisë fizike. Në momentin e inspektimit në këtë institucion ndodheshin 8 shtetas të huaj me origjinë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Maroku dhe Egjipti, të cilët nuk paraqitën ankesë tjetër para grupit të inspektimit.

Të paraburgosurit pohuan faktin se nga ana e institucionit ishin kryer disa investime të pjesshme në regjimin e brendshëm, por pavarësisht kësaj, në disa ambiente kishte lagështirë, kryesisht në ambientin ku ndodheshin tualetet dhe dushet për larjen e trupit. Pozicioni i godinës së institucionit dhe prezenca e lagështirës, ndikojnë drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Ankesa u evidentuan edhe për mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive, të cilat për shkak të mungesës së infrastrukturës nuk mund të zhvillohen. Aktivitetet e vetme që kryeshin në këtë institucion, ishin koha e ajrimit dhe lojrat e tavolinës, si dhe trajtimet psiko-sociale individuale sipas programit të miratuar nga DPB. Grupi i inspektimit konkludon se, këto aktivitete janë të pamjaftueshme dhe nuk plotësojnë kushtet për rehabilitimin e tyre.

Po ashtu, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e MKPT-së, ato

do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse nëpërmjet seksionit të veçantë.

## **Masat mbrojtëse**

Ligji nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 6 parashikon se: *“Personeli i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale u kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së dinjitetit, nevojave fizike, sociale, profesionale, shëndetësore dhe psikologjike të të burgosurave”*.

Në çdo rast, të burgosurit i sigurohen menjëherë masa mbrojtje, mbështetje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin e tij. Një nga masat mbrojtëse që garantohet me ligj, është edhe ushtrimi i të drejtës së ankimit dhe paraqitjes së kërkesave. Të burgosurit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe ankesa në zbatim të legjislacionit në fuqi, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe të Rregullores së Brendshme të institucioneve.

Në këtë kuadër, grupi i inspektimit verifikoi dokumentacionin për funksionimin e sistemit të marrjes, trajtimit dhe zgjidhjes të kërkesë/ankesave të të paraburgosurve drejtuar institucionit, si dhe menaxhimin e korrespondencave jashtë institucionit. Sipas praktikës, pas plotësimit të formularit të kërkesë/ankesave, specialisti për çështjet shoqërore i regjistron ato në regjistrin përkatës dhe më tej protokolloheshin nga sekretaria e institucionit<sup>6</sup>. Regjistri i kërkesë/ankesave ishte i sekretuar dhe i plotësuar sipas rubrikave. Drejtori i institucionit, pasi i adresonte kërkesat e të paraburgosurve sipas sektorëve, ju kthente përgjigje me shkrim ose verbalisht të paraburgosurve që kishin paraqitur kërkesa apo ankesa, brenda afateve të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Sipas shënimeve në regjistër, natyra e kërkesë/ankesave konsistonte në takime me familjarët, kërkesa për takim me avokatët mbrojtës, vizita mjekësore pranë Spitalit Rajonal Kukës, kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV dhe frigorifer etj., të cilat ishin plotësuar nga institucioni, mbi bazën e shënimeve të kryera në regjistrin përkatës. Gjatë vitit **2023** ishin regjistruar 125 kërkesa nga të paraburgosurit. Në përfundim, grupi i inspektimit administroi kopje të këtij dokumentacionit.

IEVP Kukës monitorohej nga sistemi i kamerave të sigurisë. Aktualisht institucioni kishte 18 kamera sigurie, që mbanin në vëzhgim ambientet në regjimin e brendshëm dhe ambientin e jashtëm të institucionit. Nga drejtuesit e institucionit, u informua se ishte shtuar numri i kamerave në regjimin e brendshëm, si dhe ishin zëvendësuar kamerat me shikueshmëri të dobët. Monitorimi me kamera sigurie, shërben për të rritur nivelin e sigurisë fizike të institucionit, por dhe për të parandaluar çdo rast keqtrajtimi të mundshëm të të paraburgosurve nga ana e punonjësve të sigurisë që kryjnë shërbim në këtë regjim. Të dhënat që gjeneroheshin nga sistemi i kamerave, administroheshin nga drejtori i institucionit dhe ruheshin në server për një periudhë 1 muaj.

Grupi i inspektimit, verifikoi gjithashtu dhe dokumentacionin që mbahej nga Komisioni i Pritjes dhe Komisioni i Dhënies së Masave Disiplinore në institucion. U evidentua se procedura e ndjekur nga anëtarët e komisioneve ishte në përputhje me legjislacionin dhe

---

<sup>6</sup> Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Praktika e ndjekur regjistrohej në formularët dhe regjistrin përkatës, të cilët ishin të protokolluar.

Në mjedisin e regjimit të brendshëm, ndodheshin 2 (dy) aparate telefonik që u shërbenin të paraburgosurve për të komunikuar me familjarët dhe të afërmit e tyre. Në intervistat e zhvilluara, të paraburgosurit deklarorin se respektohej numri 2 herë në javë i telefonatave me familjarët, sikurse përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit. Për shtetasit e huaj nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe vendet tjera, nuk kishte kufizime në numrin e personave për të komunikuar me familjarët apo për konfirmimin e numrave të telefonave në listën e miratuar, sikurse veprohet me të paraburgosurit e tjerë.

Takimet e të paraburgosurve me familjarët, zhvilloheshin 4 (katër) herë në muaj, të ndara në 3 (tre) takime fizike dhe 1 (një) takim online. Takimet fizike zhvilloheshin në një prej dhomave që ndodhej në regjimin e brendshëm të institucionit. Në hyrje të regjimit të brendshëm ndodhej edhe një dhomë ku ishte vendosur një monitor (kompjuter), për lidhjen me “skype” me familjarët e tyre.

Nga intervistat me të paraburgosurit, nuk pati ankesa për mosrespektimin e numrit të takimeve me familjarët, por ata kishin kërkesa për zëvendësimin e takimeve fizike me takime online me familjarët, pasi një pjesë e tyre kishin familjet larg dhe nuk kishin mundësi ekonomike të zhvillonin takime fizike çdo javë.

Në regjimin e brendshëm ndodhej një klasë edukimi, e cila shërbente njëkohësisht si bibliotekë, por dhe si ambient kulti për besimtarët mysliman dhe të krishterë, në kryerjen e riteve fetare.

Në I EVP Kukës, në hyrje të regjimit të brendshëm, ishte instaluar një skaner urë, i cili shërbente për kontrollin e personelit të vizitorëve që hyjnë në regjimin e brendshëm, si dhe për të rritur sigurinë e institucionit.

Në I EVP Kukës ishin të punësuar 4 të paraburgosur, siç ishte përcaktuar në strukturën organike, në pozicione pune si sanitare, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi etj. Sipas intervistave me të burgosurit, punësimi paraqet interes për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM-në nr. 209, datë 06.04.2022, si dhe VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”; të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 “Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në I EVP dhe pagesat e tyre”. Avokati i Popullit konsideron që të shihet me prioritet punësimi i burgosurve të huaj, përse ato kanë më të vështirë të përfitojn të holla e të kenë mundësinë e marrjes së ushqimeve shtesë.

### **Kushtet materiale**

Grupi i MKPT-së, inspektoi dhomat e banimit të të paraburgosurve, si dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm, me qëllim plotësimin e kushteve materiale, në kuadër të respektimit të standardeve për jetesë normale.

Kushtet materiale në regjimin e brendshëm të institucionit ishin në përgjithësi të përmirësuara. Nga ana e institucionit ishin kryer disa investime me fondet e tyre, për reduktimin e nivelit të lagështirës kryesisht në ambientet e dhomave. Ambientet e banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishte krijuar një ambient i veçantë për ajrimin e të paraburgosurve. Ambientet e institucionit ishin të dezinfektuara dhe nuk u evidentua prania e insekteve.

Në regjimin e brendshëm ndodheshin 16 dhoma për banim. Hapësirat e dhomave për të paraburgosurit, **nuk** janë sipas kërkesave për jetesë normale dhe nuk përmbushin kushtet shëndetësore e higjienike. Pozicioni që ato ndodhen (nën nivelin e tokës), nuk i përshtatet kushteve klimatike të zonës, sikurse parashikohet në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare<sup>7</sup>. Kubatura e dhomave për banim ishte më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja banimit më pak se 4 m<sup>2</sup>, për çdo të burgosur. Nisur nga përmasat e dhomave, aty mund të akomodohen 1-2 persona, ndërkohë që në tre dhoma ishin akomoduar deri edhe 6 persona. Sa më sipër, qëndrimi në këto kushte përbën trajtim jo human për të paraburgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, duke konsideruar edhe mbi popullimin evidentuar në 6 mujorin e fundit.

Dhomat për banim ishin të kompletuara me materiale për fjetje si krevat, dyshek, batanije dhe çarçafë për çdo të paraburgosur. Asnjëri prej tyre nuk flinte me dyshekë në tokë, por në krevatë dysh në formë “marinari”. Brenda hapësirave të dhomave, të paraburgosurit kishin vendosur komodina dhe rafte për ruajtjen e ushqimeve dhe mbajtjen e sendeve personale. Në dhomat me 3, 4 dhe 6 persona, në pamundësi të vendosjes së komodinave për çdo të paraburgosur, materialet personale ruheshin në çanta të vendosura në dysheme. Sa më sipër, jetesa në këto kushte përbën trajtim jo dinjitoz për këta persona.

Në regjimin e brendshëm, ndodhej një klasë edukimi e cila shërbente njëkohësisht dhe si bibliotekë, ku zhvilloheshin nga punonjësit e sektorit për çështjet shoqërore këshillime individuale dhe trajtime psiko-sociale me të paraburgosurit, në mungesë të aktiviteteve dhe veprimtarive të përbashkëta me grupe.

Sikurse theksuam më lart, dritaret e dhomave të banimit ishin me përmasa të vogla 80x60 cm dhe nuk mundësonin ajrim të mjaftueshëm e ndriçim të plotë natyral për të lexuar dhe punuar. Në pjesën e jashtme ato ishin të përforcuara me skara hekuri. Mundësia e zgjerimit të dritareve është e pamundur, për shkak të strukturës dhe pozicionit që godina e regjimit të brendshëm ndodhet nën nivelin e tokës. Por, drejtuesit e institucionit shtronin nevojën e zëvendësimit të tyre, pasi ato janë të amortizuara dhe nuk mbyllen hermetikisht, duke lejuar hyrjen e të ftohtit në këto ambiente.

Në këto kushte, duke vlerësuar kushtet e klimës së zonës, hapësirës së nevojshme për jetesë për person, mungesës së ajrimit, ndriçimit, mjediseve të pamjaftueshme në regjimin e brendshëm në këtë institucion, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ambientet në regjimin e brendshëm të I EVP Kukës përgjithësisht nuk garantojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe nuk plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike sipas standardeve të të paraburgosurve.

---

<sup>7</sup> Neni 33 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.



Kushtet materiale, përbëjnë kushtin kryesor për jetesë normale për të burgosurit. Pavarësisht vendit ku është ngritur institucioni dhe shërbimeve që ofron për të paraburgosurit, në tërësi kushtet e akomodimit bien në kundërshtim edhe me Rregullin 13 “Rregullat e Mandelës”, të miratuara nga OKB, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Hapësirat e akomodimit për të burgosurit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore. Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet kushteve klimatike dhe veçanërisht ajrosjes, hapësirës minimale për banim, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit”*.

Në regjimin e brendshëm ndodhej një dhomë e cila shërben për takime të të paraburgosurve me avokatët mbrojtës, prokurorin e çështjes ose oficerë të policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave. Ajo ishte e lyster dhe e pastër nga ana higjieno-sanitare, por nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave të sigurisë.

IEVP Kukës ka një dhomë observimi dhe një dhomë veçimi, të cilat ishin të kompletuara me nga një krevat dhe materiale për fjetje, në të njëjtat kushte me dhomat e tjera. Në momentin e inspektimit në dhomën e observimit ndodhej një i paraburgosur që vuante nga një sëmundje, që sipas rekomandimit të mjekut, duhet të qëndrojë i diferencuar nga të paraburgosurit e tjerë.

Furnizimi me ujë kryhej nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit të Kukësit dhe ishte pandërprerje gjatë 24 orëve. Nga ana e institucionit ishin siguruar dhe 2 çisterna rezervë, të cilat mundësonin furnizimin me ujë pa ndërprerje, në rastet e defekteve të ujësjellësit.

Për larjen e rrobave të të burgosurve, kishte lavatriçe, e cila shërbente për larjen e rrobave apo të materialeve të çarçafëve, por sipas pretendimit të të burgosurve ky proces vonohej shumë, ndaj ata preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familjet e tyre. Në këtë kuadër ata kërkonin shtimin me një lavatriçe tjetër për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi.

Nga inspektimi rezultoi se ambienti i tualetit/dusheve ishte funksional dhe i pajisur me nyje të reja hidrosanitare. Kalendari i dusheve ndodhej i afishuar, gjithsesi nga pohimet e të paraburgosurve u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve dhe përtej parashikimeve të planifikuara.

Ambientet e brendshme dhe të jashtme të institucionit, kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik i qytetit. Në rast defekti apo ndërprerje të energjisë elektrike nga rrjeti, institucioni kishte si burim alternative një gjenerator që furnizonte me energji elektrike ambientet e IEVP-së dhe të DVP Kukës, që ndodhen brenda të njëjtit territor.

IEVP Kukës nuk ka mjedise të hapura, për shkak të pozicionit që ndodhet godina e paraburgimit, ndaj nuk mund të zhvillohen aktivitete sportive si futboll, basketboll, etj. I vetmi mjedis i hapur ishte ai i ajrimit, i cili ishte i kufizuar në hapësirë dhe nuk ofron asnjë mundësi për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, përveç lojërave të tavolinës.

Kuzhina e institucionit ndodhej jashtë ambientit të regjimit të brendshëm. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të vogël, dhe mbahej pastër nga personeli i saj. Gatimi i ushqimit dhe ruajtja e produkteve ushqimore bëhej në të njëjtin ambient. Gatimi kryhej rregullisht për 3 vakte ushqimore për të paraburgosurit e IEVP-së, si dhe për personat e ndaluar/arrestuar në

dhomat e sigurisë të DVP Kukës. Grupi i inspektimit nuk mori ankesa nga të paraburgosurit për ushqimin. Sipas intervistave, ushqimi ishte i cilësisë së kënaqshme dhe konsumohej nga të paraburgosurit. Për të sëmurët me diabet, ushqimi gatuhej më vete.

Personeli i kuzhinës sipas organikës përbëhej nga 2 punonjës. Në një stendë të vendosur në mur ishin të afishuara librezat shëndetësore të kuzhinierëve, të cilat ishin të përditësuara bashkë me menunë javore dhe kuotat ditore me vlerat kalorike, të cilat rezultuan të ishin brenda normativave të miratuara. Nga inspektimi u konstatua se, kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike. U evidentua se, në kuzhinë mungonte aspiratori për të evituar erërat, tymrat dhe aromat nga gatimi i ushqimit, konstatim i përsëritur dhe në inspektimin e mëparshëm.

Të paraburgosurit ngritën me shqetësim dhe mungesën e dyerve me skara në regjimin e brendshëm, pasi ambienti është i mbyllur. Gjithashtu, dyert e dhomave ekzistuese ishin të amortizuara dhe të vjetëruara, ndaj është e nevojshme edhe zëvendësimi i tyre, të cilat do garantonin sigurinë dhe ajrimin e dhomave të banimit.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

Programi ditor i veprimeve ishte i miratuar nga drejtori i institucionit dhe ishte i afishuar në korridorin e regjimit të brendshëm dhe në klasën e edukimit. Aktivitetet kryesore në këtë IEVP përfshinin lojëra tavoline, aktivitete fetare, si dhe aktivitete kulturore me rastin e festave të ndryshme.

Orari i veprimeve ishte i afishuar. Në lidhje me ajrimin, rezultoi se të paraburgosurit qëndronin më vete 4-5 orë në ajrim, 2-3 orë paradite dhe 2 orë pasdite. Në ambientet e ajrimit zhvilloheshin lojëra si shah, domino, letra etj., ndërsa hapësira për ecje ishte mjaft e kufizuar.

Ky aspekt është problematik për mundësimin e kushteve të pranueshme për jetesë së të paraburgosurve.

Punonjësi i sektorit të çështjeve shoqërore, kishte hartuar programe individuale këshillimi dhe trajtimi psiko-social me të paraburgosurit. Sipas programeve mujore, me të paraburgosurit ishin zhvilluar tema dhe recensione të librave të cilat konsideroheshin si aktivitete informuese dhe edukative.

Në institucion nuk kishte persona me probleme të shëndetit mendor, ndërsa për të paraburgosurit e ardhur rishtas në këtë IEVP kishte programe të veçanta për këtë kategori, në lidhje me informimin e tyre për të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë personat e privuar nga liria në këtë institucion.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit duhet të jetë proaktiv për të krijuar sa më shumë aktivitete, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të paraburgosurve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut.

Avokati i Popullit vlerëson se ky institucion nuk i ka kushtet infrastrukture për të realizuar procesin e rehabilitimit dhe realizimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve siç parashikohet në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në këto kushte, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Kukës janë të domosdoshme organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, çlodhëse e sportive me të paraburgosurit. Këto aktivitete, duhet të shërbejnë për motivimin dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë, rritjen e vetëbesimit, si dhe nxitjen e interesit për arsimimin dhe formimin profesional të të paraburgosurve.

Në këtë kuadër, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”<sup>8</sup>.

Grupi i inspektimit verifikoi gjithashtu plotësimin e dosjeve psiko-sociale për secilin të paraburgosur, të cilat ishin të plotësuara sipas rubrikave dhe të përditësuara, me përmbledhje nga takimet e fundit me të paraburgosurit, vlerësimet e tre mujorëve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Sektori i edukimit kishte në organikë 1 (një) specialist me profesion psikolog ose punë sociale.

### **Shërbimi shëndetësor**

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek dhe 5 infermierë. Aktualisht, mjeku punonte me kontratë me kohë të pjesshme, 4 orë në ditë dhe në çdo kohë kur kishte të paraburgosur me probleme të rënda shëndetësore. Ndryshe nga inspektimet e mëparshme, të paraburgosurit nuk i paraqitën ankesa grupit të inspektimit, për vonesa apo zvarritje në kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku i institucionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua se regjistrat e terapisë ditore, marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, kartelave dhe ngjarjeve të rënda ishin të plotësuara dhe mbajtur në mënyrë të rregullt. Kartelat mjekësore të të paraburgosurve, mbaheshin me çelës në zyrën e mjekut, e cila në mungesë të ambienteve të punës për administratën e institucionit, shërbente njëkohësisht edhe si zyrë për financën dhe logjistikën.

Dhoma e infermierisë, ndodhej në regjimin e brendshëm, e cila ishte e rregullt dhe e mirëmbajtur, e pajisur me shtrat, tavolinë pune dhe raftë për mbajtjen e medikamenteve dhe regjistrat ku evidentoheshin rastet e dhënies së ndihmës mjekësore për të paraburgosurit.

Furnizimi me medikamente për pacientët kronikë kryhej sipas skemës tre palëshe midis IEVP-së, degës së FSKSH-së Kukës dhe Depos Farmaceutike. Përveç kësaj skeme, IEVP Kukës furnizohej me medikamente edhe nga DPB. Në rastet e mungesës së medikamenteve, përdorej fondi i vënë në dispozicion në buxhetin e institucionit, për këtë qëllim. Në rastin kur ilaçet siguroheshin nga familjarët, ato administroheshin nga infermierët e turnit dhe sipas rekomandimit të mjekut të institucionit, u jepeshin të paraburgosurve të sëmurë me sëmundje

---

<sup>8</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve; Pika 25/1 dhe 25/2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

kronike. Institucioni nuk ka në organikë farmacist, por detyrën e kryen njëri prej infermierëve.

Të paraburgosurit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Asgjësimi i ilaçeve të skaduara bëhej me komision, praktika e të cilit evidentohet në procesverbalet përkatëse. Ndërkohë gjithë procesi i asgjësimit të ilaçeve të skaduara, regjistrohej në mënyrë filmike.

Në organikën e IEVP Kukës nuk kishte stomatolog, kështu që në kushte të tilla, shërbimi stomatologjik mundësohej jashtë institucionit nga ofrues privat dhe mbulohej financiarisht nga familjarët e të burgosurve.

Shërbimi i stomatologjisë për të paraburgosurit mbulohej nga poliklinika e qytetit të Kukësit ose në shërbim privat me rekomandimin e mjekut të institucionit. Për këto raste, institucioni mbulon shpenzimet e lëvizjes, ndërsa shpenzimet e mjekimit mbulohen nga vetë i paraburgosuri.

Referuar nenit 41 të ligjit 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, në pikën 3 thuhet se: *“Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të burgosurve. Organizimi dhe realizimi i kujdesit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë”*. Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon shtimin në organikë të pozicionit për stomatolog dhe krijimin e një dhomë të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim në lidhje me ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit.

Institucioni nuk kishte makinë autoambulancë, për shoqërimin e të sëmurëve në Spitalin Rajonal të Kukësit. Në rastet e urgjencave, njoftohet menjëherë urgjenca e spitalit dhe i paraburgosuri dërgohej për trajtim të specializuar mjekësor. Si rezultat i bashkëpunimit midis dy institucioneve, në Spitalin Rajonal Kukës ishte përshtatur një hapësirë me dy dhoma, me hyrje më vete e dedikuar për shtrimin e personave të paraburgosur, e cila plotësonte parametrat e sigurisë.

Në IEVP Kukës kishte disa të paraburgosur me probleme shëndetësore e konkretisht, 4 të sëmurë kronikë, të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës së IEVP Kukës ishin **afishuar postera** me të drejtat ligjore të burgosurve të cilat të ishin të aksesueshme nga këta persona.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e*

*individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave, për rikonstrukcionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në I EVP Kukës për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave për futjen e ajrit dhe dritës natyrale sipas kriterëve teknike të sigurisë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përcaktimin e kapaciteteve të I EVP-së në përputhje me parametrat e nevojshme jetësorë sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Marrjen e masave, për të garantuar akomodimin e të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m<sup>2</sup> dhe 4m<sup>2</sup> për person.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në I EVP Kukës, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor të institucionit me 1 mjek të përgjithshëm me kohë të plotë dhe shtimin në organikë të 1 (një) farmacisti dhe të 1 (një) mjeku stomatolog, me kohë të plotë me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për blerjen e një aspiratori për ajrim në kuzhinën e institucionit.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e policisë së institucionit.
8. Marrjen e masave, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
9. Marrjen e masave, për pajisjen e lavanierisë me lavatriçe shtesë, për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi, në mënyrë që të jetë në proporcion me numrin e personave të akomoduar.
10. Marrjen e masave, për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.
11. Marrjen e masave të menjëhershme, për organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe ri-integrimin e këtyre personave.

12. Marrjen e masave, për rritjen e pranisë së punonjësve të sektorit juridik në kontakte të përditshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**